

ANEKSI 3

Fondi për Zhvillimin e Rajoneve dhe Programi për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale

1. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve është një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor.
2. Për vitin 2019, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përbëhet nga granti konkurrues për arsimin.
3. Shpërndarja e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve sipas projekteve kryhet nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve, i cili kryesohet nga Kryeministri dhe ka këtë përbërje:

| | |
|---|------------------|
| 1. Kryeministrin | Kryetar |
| 2. Zëvendëskryeministrin | Zëvendëskryetar; |
| 3. Ministrin e Financave dhe Ekonomisë | anëtar; |
| 4. Ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë | anëtar; |
| 5. Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale | anëtar; |
| 6. Ministrin e Kulturës | anëtar; |
| 7. Ministrin e Brendshëm | anëtar; |
| 8. Kryetarin e Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë | anëtar; |
| 9. Kryetarin e Shoqatës për Autonomi Vendore | anëtar; |
| 10. Kryetarin e Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë | anëtar; |

Në mungesë të kryetarit të Komitetit, mbledhja drejtohet nga zëvendëskryetari.

4. Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve miraton:
 - a) Specifikimet, rregullat dhe kriteret për financimin e projekteve dhe ndarjen e grantit të arsimit;
 - b) Shpërndarjen e fondeve për financim për projekte të reja investimi;
5. Fondi i Zhvillimit të Rajoneve me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces. Pjesa e financimit të projekteve në proces vendoset në listën e investimeve të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në përputhje me ecurinë e projektit. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë mund të kërkojë rialokime midis projekteve të FZHR-së, sipas procedurave të miratuara për investimet publike.
6. Thirrjet për aplikim në Fondin e Zhvillimit të Rajoneve për vitin buxhetor mund të bëhen që në Nëntor të vitit paraardhës.
7. Fondi i Zhvillimit të Rajoneve nuk trashëgohet në vitin e ardhshëm, buxhetor.
8. Sekretariati teknik për grantin për arsimin ngrihet pranë Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve është një njësi pranë Kryeministrisë.
9. Subjektet aplikuese dhe zbatuese janë njësitë e vetëqeverisjes vendore. Komiteti miraton me vendim autoritetin kontraktor për zbatimin e projektit. Rregulla të hollësishme lidhur me raportimin e autoriteteve kontraktuese miratohen me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

Programi buxhetor për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale në Fondin Shqiptar të Zhvillimit

1. Fondet për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale, të parashikuara si program buxhetor në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, janë një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor.
2. Specifikimet, rregullat, kriteret për financimin e projekteve si dhe shpërndarja e Fondit për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale për financimim e projekteve të reja kryhen nga Këshilli Drejtues i Fondit Shqiptar të Zhvillimit.
3. Subjektet aplikuese dhe zbatuese për fondet e programit Infrastruktura Vendore dhe Rajonale janë njësitë e vetëqeverisjes vendore.
4. Zbatimi i projekteve të miratuara me vendim të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit është përgjegjësi parësore e autoriteteve kontraktuese, të cilët zbatojnë projektet, sipas rregullave dhe akteve ligjore e nënligjore përkatëse.
5. Nga fondi për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale, Fondi Shqiptar i Zhvillimit me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces me burim financimi ish-Fondin e Zhvillimit të Rajoneve-Infrastrukura Vendore dhe Rajonale. Pjesa e financimit të projekteve në proces vendoset në listën e investimeve të FSHZH-së, në përputhje me ecurinë e projektit. Fondi Shqiptar i Zhvillimit mund të kërkojë rialokime midis projekteve, sipas procedurave të miratuara për investimet publike.
6. Rregulla të hollësishme lidhur me funksionimin e të gjithë procesit që nga shpallja e thirrjes deri në aprovimin për financim, si dhe raportimin e autoriteteve kontraktuese do të miratohen me vendim të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.